# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-455927**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mali i Zi bën pagën minimale 1000 euro/ Nga janari 2027 nis "Euro Model" |
| ADRESA | `https://tpz.al/mali-i-zi-ben-pagen-minimale-1-400-euro-nga-janari-2027-nis-euro-model-i333286` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 16:54:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 16:33:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f1446993141a65415c0279d23f38df50c15490e32b8e354ee8a4323a8fcafc04` |
| TEKSTI | `355b6703f71672e35fe8457a4326f86a94657c885175ba24270c401707cced85` |
| PAMJA | `a56cf8c34ef10c6ba71aeef7efd50680e14e5f7ba2c050915a7736b7cc1bb66c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0f95c109f9a8095ea1f6c1ff89672399bf9177cfaf5c2f9384cd160eded5ae9d` |
| E MËPARSHMJA | `bedeba9f20be8044e9cf417782dece3ecccfffa671e8e91b59863c92dd45afd4` |
| RRËNJA MERKLE | `0188b89a08595528a7763f43617734e52df4cad134485b32e03065e5637ea5a1` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0f95c109f9a8095ea1f6c1ff89672399bf9177cfaf5c2f9384cd160eded5ae9d`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BALLKAN, 18 SEPTEMBER 2026, 18:33

# Mali i Zi bën pagën minimale 1000 euro/ Nga janari 2027 nis "Euro Model"

TPZ



Mali i Zi synon një rritje të fortë të pagave duke nisur nga janari i vitit 2027. Qeveria ka miratuar paketën e ligjeve që i hap rrugën modelit të ri të pagave, të quajtur "Euro Model", i prezantuar nga kryeministri Milojko Spajić. Sipas skemës së njoftuar, paga minimale neto do të jetë 1,000 euro për vendet e punës me arsim bazë ose më të ulët, 1,250 euro për ato me arsim të mesëm dhe 1,400 euro për vendet e punës që kërkojnë arsim të lartë.

Por reforma nuk parashikon rritje vetëm për punonjësit me pagë minimale. Qeveria synon të ulë më tej taksat dhe kontributet mbi punën, në mënyrë që një pjesë më e madhe e kostos që paguan biznesi të përfundojë në pagën neto të punonjësit. Spajić dha edhe një shembull konkret. Për një punonjës që sot merr 1,600 euro neto, punëdhënësi shpenzon rreth 1,980 euro. Me modelin e ri, sipas përllogaritjeve të qeverisë, me të njëjtën kosto prej 1,980 eurosh, paga që merr punonjësi do të rritej në 1,870 euro neto.

Në total, qeveria përllogarit se nga ndryshimet do të përfitojnë më shumë se 250 mijë të punësuar, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik. Synimi është që rritja më e madhe në përqindje të shkojë te punonjësit me të ardhurat më të ulëta.

"Euro Model" prek edhe pensionet. Nga viti 2027 ato parashikohet të indeksohen katër herë në vit, ndërsa qeveria pret që pensioni mesatar të kalojë 600 euro dhe pensioni minimal të jetë mbi 500 euro. Përpara hyrjes në fuqi të skemës, në dhjetor 2026, qeveria ka njoftuar edhe një pagesë shtesë prej 100 eurosh për çdo pensionist.

Por rritja e fortë e pagave ngre edhe pyetjen se si do të financohet reforma. Qeveria argumenton se kostoja do të mbulohet nga rritja e konsumit dhe punësimit, lufta kundër ekonomisë informale, disiplina e shpenzimeve, kthimi i diasporës dhe masa të tjera fiskale. Në këtë

## ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

## Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

## Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

## Moti

Tirana, Albania

## WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

kuadër, Podgorica paralajmëron edhe një masë që prek tregun e pronave: rritjen e vemendjes ndaj tatimit mbi banesat dhe shtëpitë e treta që mbahen bosh, me argumentin se një pjesë e stokut të banesave mbetet jashtë tregut ndërkohë që të rinjtë përballen me qira të larta.

Ambicia e Podgoricës është që efekti i reformës të mos ndalet te pagat minimale. Reforma lidhet nga qeveria edhe me procesin e integrimit europian dhe përpjekjen për të frenuar emigracionin. Mesazhi i Spajić për malazezët që jetojnë jashtë vendit ishte i drejtpërdrejtë: "Kthehuni. Mali i Zi ju pret."


BALLKAN / 18 September 2026, 16:49

**Ish-ambasadori Bosch: Specialja nuk duhej të ekzistonte, vendimi ndaj Thaçit dhe ish-krerëve të UÇK-së skandaloz**

BALLKAN / 18 September 2026, 15:40

**Serbia hap fabrikën e dronëve izraelitë, Vuçiç: Do të furnizojmë edhe ushtri të tjera**

BALLKAN / 18 September 2026, 15:32

**Mediat serbe kryqëzojnë artisten Leonora Jakupi: Ajo po përkrah gjarprin, Hashim Thaçin!**

BALLKAN / 18 September 2026, 13:32

**"Fonde e ekspertë"/ Dënimi i ish-krerëve të UÇK, 4 kërkesat e protestuesve: Nga shfuqizimi i ligjit për Dhomat e Specializuara tek shkarkimi i Gërvallës**

BALLKAN / 18 September 2026, 13:12

**Kosova proteston kundër 'Speciales', Gucati-Kurtit: Largoje Gërvallën, ra pre e ndikimit të Serbisë! Bashkëpunoi me armikun**

BALLKAN / 18 September 2026, 12:25

**'Po tentoni të vrisni edhe njëherë popullin shqiptar'/ Dënimi i ish-krerëve të UÇK nga Gjykata Speciale, Prishtina në protestë**

BALLKAN / 18 September 2026, 11:31

Prishtinë/ PDK pritet të dorëzojë sot në Kuvend nismën për ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Speciale

BALLKAN / 17 September 2026, 21:29

Haxhiu: UÇK-ja nuk mbrohet duke shpallur kundërshtarët "spiunë" e "tradhtarë"

BALLKAN / 17 September 2026, 20:26

Pamje të papublikuara nga bastisja e shtëpisë së Jakup Krasniqit, ishte edhe hetuesja e lidhur me dëshmitarin e paguar nga Serbia (VIDEO)

BALLKAN / 17 September 2026, 19:14

Djali i Kadri Veselit rrëfen momentet para dhe pas vendimit në Hagë: Nuk u frikësuam nga drejtësia, por nga politika!

BALLKAN / 17 September 2026, 18:36

Avokati i Thaçit: Do ta apelojmë aktgjykimin, janë bërë gabime të rëndësishme ligjore. Mesazhi i ish-presidentit të Kosovës

BALLKAN / 17 September 2026, 18:09

REL: Aktgjykimi i Hagës ndaj katër ish-udhëheqësve të UÇK-së përballë historisë së luftës së Kosovës

BALLKAN / 17 September 2026, 17:52

Kurti takim me kreun e PDK pas verdiktit të Hagës: Vendimi duhet të përmbyset në Apel

BALLKAN / 17 September 2026, 16:25

FAZ ngre pikëpyetje për dënimet ndaj ish-krerëve të UÇK-së: A janë proporcionale me ato të kriminelëve serbë të luftës?

BALLKAN / 17 September 2026, 15:45

**“Një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë buzëqeshje pas atij vendimi”/ Përlotet vajza e Jakup Krasniqit: Ja mesazhi që na ka lënë**

BALLKAN / 17 September 2026, 15:24

**Gjykata Speciale, Hamza paralajmëron hapa konkretë: Do të takohem me liderët politikë, PDK ka gati 22 nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme**

BALLKAN / 16 September 2026, 22:55

**“Vendimi i Hagës, shokues” - Edward P. Joseph: Serbia do ta përdorë për të diskretituar UÇK-në**

BALLKAN / 16 September 2026, 22:07

**Pas vendimit të Hagës, reagon për herë të parë djali i Hashim Thaçit: Historinë e UÇK-së nuk mund ta ndryshojë asnjë vendim**

BALLKAN / 16 September 2026, 21:57

**“Jam i shokuar dhe i zemëruar" - Ish-komandanti i NATO-s: Nuk kam parë asnjë dëshmi që të justifikojë dënimin e krerëve të UÇK-së**

BALLKAN / 16 September 2026, 21:37

**Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së në Hagë/ Dua Lipa dhe Rita Ora në mbështetje të Çlirimtarëve**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.